



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe Rregullës Nr. 01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, nenit 21, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 30.08.2019 merr këtë:

VENDIM

për mos aprovim të kërkesës së partisë politike – Partija Kosovskih Srba

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për partinë politike, Partija Kosovskih Srba me akronimin PSK, për mos aprovim të kërkesës për tu mos sanksionuar për mosdorëzimin me kohë të Formularit për azhurnimet vjetor dhe të Raportit Vjetor Financiar.
- II. Kërkesa e dorëzuar nga PKS konsiderohet si a pasafatshme.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike “Partija Kosovskih Srba -PKS”, për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me datë 10 qershor, 2019, kryetari i PKS, z. Aleksandar Jablanovic, ka dorëzuar në zyrat e ZRPPC-së një kërkesë për tu mos sanksionuar për mosdorëzimin me kohë të: a) Formularit për azhurnimet vjetore, b) Raportin Vjetor Financiar. Në të njëjtën ditë, kryetari i PKS-së ka dorëzuar Formularin për Njoftimin e Ndryshimeve të Partisë Politike, i cili mban datën 31 mars 2019 si dhe Raportin Vjetor Financiar për PKS i cili tregon se PKS nuk ka pasur hyrje/dalje financiare gjatë periudhës raportuese. Z. Jablanovic ka shpjeguar që personi kontaktues për financa dhe personat kontaktues për një periudhë të gjatë kanë qëndruar jashtë Kosovës dhe nuk e kanë njoftuar atë si Kryetar për kërkesat me email që ju kanë dërguar nga Zyra. Për më tepër, z. Jablanovic pohon që ka pasur probleme shëndetësore që i kanë pamundësuar ardhjen në Zyrë për tu interesuar për të bërë ndryshimet e nevojshme dhe për të dorëzuar edhe pse me vonesë disa nga formularët e obligueshëm. Por, sipas nenit 21 të Rregullës 1/2013, kërkesat për zgjatje të afateve ligjor duhet të dorëzohen pesë ditë para përfundimit të afatit të paraparë për dorëzim të dokumentacionit të kërkuar. Për shkak të kalimit të këtij afati kërkesa e tillë shpallet e pas-afatshme.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Valdete Daka, Kryetare

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Prishtinë / Pristina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA